



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



Drejtoria për Inspektion
Nr. 10 ____/2026

NJOFTIM

Duke marrë parasysh numrin e madh të vizitorëve që gjatë kësaj periudhe verore, me temperatura të larta, frekuentojnë zonat e Ujit të Thartë apo "Gushavcit", të njohura për bukurinë natyrore dhe freskinë e tyre, është vërejtur se disa persona, në mënyrë të papërgjegjshme, gjatë qëndrimit në këto hapësira, pas largimit lënë mbeturina pas ose i hedhin në vende të papërshtatshme, duke shkaktuar ndotje të mjedisit.

Ju bëjmë thirrje të gjithë qytetarëve dhe vizitorëve:

Mos i lini mbeturinat aty ku keni qëndruar. Hidhini në kontejnerin më të afërt të mbeturinave.

Njoftohen të gjithë qytetarët se ndalohet hedhja dhe lënia e mbeturinave në hapësirat publike, përfshirë zonat e Ujit të Thartë "Gushavcit", përgjatë lumit Lumbardhë dhe në çdo hapësirë tjetër natyrore.

Çdo hedhje apo lënie e mbeturinave nga persona të papërgjegjshëm përbën shkelje dhe do të trajtohet sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Ju bëjmë thirrje për kujdes, ndërgjegjësim dhe përgjegjësi ndaj mjedisit. Ruajtja e pastërtisë së këtyre hapësirave është përgjegjësi e përbashkët dhe një mënyrë për ta ruajtur natyrën e bukur të Komunës së Deçanit për të gjithë qytetarët dhe vizitorët.

Shijoje natyrën, mos e ndot!

